

## SFIDA E GJUHËS SHQIPE DHE TEKSTET SHKOLLORE SHUMË GJUHËSH

**Agim LEKA, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”  
e-mail: leka.agim@gmail.com**

### **Abstrakt**

Qëllimi kryesor i këtij kërkimi është të identifikojë problematikat që lidhen me tekstet shkollore shumëgjuhëshe dhe të trajtojë sfidën e gjuhës shqipe në ndërtimin e mendimit kritik gjatë tranzicionit post-ideologjik, si dhe pasurimin dhe gjallërimin e saj në këtë proces. Premisa bazë e kërkimit është se “sistemi i mendimit dhe sistemi i gjuhës funksionojnë si pjesë të pandara dhe komplementare të qenies njerëzore”. Në epokën e sotme, misioni i gjuhës është të mundësojë kuptimin e mendimit kritik, niveli më i lartë i të cilit përfaqësohet nga “mendimi filozofik”. Komunikimi gjuhësor dhe ndërkomunikimi janë procese të ndërlikuara që mbështeten në zhvillimin e aftësive gjuhësore dhe përdorimin e gjuhës si mjet për të shprehur dhe argumentuar mendime me qartësi dhe thellësi. Në çerekun e parë të shekullit XXI, fusha e edukimit është zgjeruar me dije të reja që përfshijnë transitologjinë e gjuhës dhe të mendimit, psikolinguistikën, neurolinguistikën, pedagogjinë e komunikimit ndërkulturor dhe të të folurit gjuhësor. Ky kërkim mbështetet në metodën holistike dhe në analizën e faktorëve objektivë dhe subjektivë që kanë ndikuar në krizën e mendimit pas rënies së sistemit totalitar. Baza teorike e studimit është filozofia e integritit, mendimi kritik reflektiv, dhe ndërthurja e së vërtetave klasike: fetare, filozofike dhe shkencore. Kërkimi zhvillohet në kontekstin e edukimit parauniversitar, me fokus në tekstet shqipe dhe angleze, të ndërtuara sipas standardeve të kurrikulës europiane.

***Fjalë çelës:** mendimi kritik, njëjtësia kombëtare, adoptimi, tekste shkollore*

### **The Challenge of the Albanian Language and Multilingual School Textbooks**

#### **Abstract**

The primary aim of this research is to identify challenges related to multilingual school textbooks and to address the role of the Albanian language in constructing critical thinking during the post-ideological transition, along with its enrichment and revitalization throughout this process. The central premise of the research is that “the system of thought and the system of language function as inseparable and complementary components of the human being.” In today’s era, the mission of language is to enable the understanding of critical thinking, whose highest level is represented by “philosophical thought.” Linguistic communication and intercommunication are complex processes that rely on the development of language skills and the use of language as a tool for clearly and deeply expressing and arguing thought. In the first quarter of the 21st century, the field of education has expanded to include new domains such as the transitology of language and thought, psycholinguistics, neurolinguistics,

intercultural communication pedagogy, and spoken language development. This research is based on a holistic method and the analysis of objective and subjective factors contributing to the crisis of thought after the fall of the totalitarian system. Its theoretical foundation lies in the philosophy of integration, reflective critical thinking, and the synthesis of classical truths: religious, philosophical, and scientific. The research takes place within the context of pre-university education, focusing on Albanian and English textbooks developed according to European curriculum standards.

**Keywords:** *Critical thinking, national identity, adoption, textbooks*

## **Hyrje**

Kumtesa është pjesë e studimit filozofik "Racionaliteti, e vërteta dhe gjuha në epokën postmoderne". Në fushën e metafizikës, periudha kohore pas luftës së dytë botërore, e luftës së ftohtë (lufta ideologjike politike) dhe tranzicioni post totalitar, pas kolapsit të socializmit marksist-leninist është epokë post moderne. Të paktën nga koha e Sokratit dhe Konfucit, në qendër të menduarit është marrëdhënia dhe lëvizja e pandërprerë e mendjes racionale dhe e gjuhës midis të vërtetës dhe deformimit të saj. Gjuha, si instrument i komunikimit të vërtetës, ka devijuar nga linja racionale e mendimit. Gjuha shkencore shpesh ka tejkaluar përmasat midis jo racionales dhe racionales (prerja e artë) duke absolutizuar të vërtetën shkencore dhe injoruar vlerat njerëzore. Në fusha të tjera, gjuha e sfiduar nga sundimi i ideologjisë dhe i propagandës është bërë burim informimi fals. E njëjta situatë po zhvillohet edhe me gjuhën e internetit. Mendimi është i përjetshëm, aq sa është jeta njerëzore. Jetëgjatësia e gjuhës nuk përcaktohet nga madhësia e gjuhës, por nga cilësia. Gjuha që mundëson e lehtëson kuptimin e mendimit dhe i përgjigjet pyetjes "si të kuptojmë mendimin?" përballon sfidat edhe në epokën postmoderne. Të folurit e të shkruarit shqip është prova historike më se e mjaftueshme e jetëgjatësisë së gjuhës shqipe.

## **Tranzicioni nga mendimi ideologjik në mendimin kritik**

Rënia e sistemeve totalitare shënoi tranzicionin nga sistemi i mendimit ideologjik në sistemin e mendimit kritik reflektiv, nga gjuha arbitrare e realitetit të rremë me gjysmë të vërteta te gjuha kritike dhe transhendente. Në Evropën Lindore gjuha e totalitarizmit sundoi komunikimin për dekada dhe helmimi i gjuhës "ndikoi në gjendjen shpirtërore të njerëzve dhe është ende prezent, duke penguar komunikimin me Perëndimin (Magda, 2002). Në rastin shqiptar, tranzicioni mendor dhe gjuhësor është më i vështirë dhe më i ndërlikuar, për shkak të indoktrinimit ideologjik shumë shekullor që arriti kulmin me sundimin e ideologjisë komuniste gjatë gjysmës së dytë të shek. XX.

Ndërkohë, gjuha shqipe nga fillimet e shkrimit të saj e sidomos në shekujt e presioneve ideologjike ka përballuar sfidën e ideologjizimit, por nuk ka ndërprerë në asnjë kohë marrëdhëniet me gjuhët e mëdha perëndimore si dhe të fqinjëve dhe është njësuar, standardizuar, zhvilluar e pasuruar, ndërkohë që nuk kanë munguar përpjekjet për mësimin e gjuhës shqipe edhe në vendet fqinje. Në vitin 1927, Ministri i Arsimit i kohës të Shtetit Shqiptar, fillon përpjekjet për mësimin e gjuhës shqipe fëmijëve në shkollat e Korfuzit, sepse numri i tyre është i madh në atë zonë (Nathanaili, 2016: 106).

## **Njëjtësia kombëtare në vend të "Bashkimit Kombëtar"**

Çdo epokë e shoqërisë ka mendësinë/filozofinë e vet, e cila shprehet me "gjuhën filozofike apriori" si e quan Umberto Eco. Ne shqiptarët, që në agim të qytetërimit evropian, kemi ndërtuar mendësi evropiane.

Shqiptarët ruajtën vlerat më të arrira, trashëguar nga e kaluara. Ata pasuruan identitetin e tyre me vlera të arrira që siguruan të ardhme brenda trojeve të natyrshme shekullore.

Përmes gjuhës shqipe, "njëjtësia kombëtare" u modelua në të menduarit evropian të shqiptarëve. Gjatë rilindjes, të menduarit e shqiptarëve, jo vetëm nuk u pushtua nga ideologjia, por u zhvillua në nivelin e filozofisë moderne. Njëjtësimi është vlerë ontologjike dhe e orientuar shqiptare qysh nga mitologjia. Ajo është ngjizur në identitetit shqiptar që nga epoka e heronjve mitologjikë, përmes mendimit naiv/sinkretik. Rilindja Kombëtare e integroi "njëjtësinë kombëtare" mbi bazën e "njëjtësia gjuhës shqipe". Pas epokës së Rilindjes, mendësia ideologjike ndërtoi konceptin (togfjalëshin) "Bashkim Kombëtar". Aq shumë ka zënë vend ky term sa që "European Union", në tekstet shqip përkthehet "Bashkimi Evropian"!

"Bashkimi" është vlerë ontologjike e kombit shqiptar. "Union" nuk është "bashkim" por integrim. Integrimi ruan dhe pasuron përmasën e identitetit të shqiptarëve. Bashkimi nuk ruan identitetet por redukton ato. Lëvizja e pandërprerë e gjuhës shqipe është premisa e filozofisë së Albanologjisë moderne e sintetizuar në njëjtësinë kombëtare. Filozofia e njëjtësisë kombëtare është fusha e dijes që na ndriçon si të veprojmë lokalisht dhe si të mendojmë globalisht. Nga lashtësia e antikitetit deri sot, të folurit shqip ndjek vijën natyrore transitive të zhvillimit sipas "prerjes" [ratio] së mendimit racional. Në epokën e integritit, gjuha shqipe ka sfida më të mëdha se sa gjuhët e tjera. Progresi i shkencës e teknologjisë, bota virtuale e internetit po ndërtojnë sistemin e ri të termave kyçe të mendimit, përmes mjeteve të sofistikuara të komunikimit e interkomunikimit të integruar rajonal e global.

Filozofia dhe gjuhët funksionojnë si sisteme dijeshe integrale dhe diferenciale. Edhe në komunikim mes tyre si dhe me fusha të tjera. Është një rrjet marrëdhëniesh mes sistemeve dhe jo thjesht marrëdhënie mes subjekteve njerëzore apo mes tyre e lëndëve (material/mësimore).

### **Shqipërimi dhe adoptimi i teksteve shkollore**

Shumë-gjuhësia është realitet e fenomen objektiv i epokës së integritit global dhe sfidon edukimin e publikut. Dy gjuhësia nis më së pari në familje. Kjo do të thotë se familja shqiptare, veçanërisht në diasporë e emigrim, përballet me sfidën e nxënies së gjuhës amtare ose gjuhës së familjes. Në kontekstin e shkollimit, është kërkesë e ditës, që mësuesit e gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të tjera, nuk mund ta përballojnë sfidën pa zotëruar minimalisht metodologjinë e nxënies përmes situatave multi-gjuhësore. Mësuesi i shek. XXI nuk mund të jetë i suksesshëm me nxënien tradicionale, përmes situatave mësimore një-gjuhëshe. Koha u kërkon mësuesve të gjuhëve jo-shqipe të ndryshojnë radikalisht metodologjinë e nxënies në kushtet e shumë gjuhësisë.

Në sistemin e shkollimit, gjuha shqipe sfidohet edhe si gjuhë e folur dhe e shkruar. Tekstet shkollore të nivelit para universitar shqiptar, në disa fusha të dijeve, janë nga gjuha angleze. Shumë gjuhësia në arsimin e lartë është tashmë pjesë organike dhe e natyralizuar që lehtëson integrimin me partnerët ndërkombëtarë. Për pasojë, gjuha shqipe përballet me sfidën e përkthimit. Në të njëjtën kohë, përkthimi është përjasur drejt botës së marketingut dhe propagandës, duke u fokusuar gjithnjë e më shumë në publicitet e informacion e duke ju shmangur formimit të vlerave dhe mendimit kritik. Ka ardhur koha që të hiqet nga kurrikula shkollore, institucionet e literature termi "gjuhë e huaj", sepse nuk funksionon dhe pengon mendimin kritik. Gjuhët e tjera, në marrëdhënie me gjuhën shqipe, janë "jo shqipe" por jo "të huaja". Në rastin përkthimit, ne mund të përdorim termat "shqipërim". Në këndvështrimin juridik përdoret termi "adoptim" (adopt/ój) ose në gjuhën shqipe "birësoj".

Në kohën tonë, shqipërimi (rikonceptimi) i koncepteve kyçe dhe i terminologjisë (fjalori terminologjik) së fushave të teksteve shkollore janë hallka kryesore për lehtësimin e nxënies, përmes të kuptuarit. Zhvillimi i terminologjisë, faktorët gjuhësorë dhe jo gjuhësorë, subjektivë e objektivë janë aq të integruar mes tyre, sa përcaktojnë "vijën e drejtimet e përgjithshme të funksionimit të terminologjinë në çdo fushë dije të veçantë" (Duro, 2009). Adoptimi nga gjuha shqipe i teksteve jo shqipe, jo vetëm lehtëson nxënien e tyre, por zgjidh juridikisht marrëdhëniet e botuesve shqiptarë me autorët jo shqiptarë, duke respektuar të drejtën e autorit si dhe racionalizon, zbukuron dhe motivon ligjërimin libror shqip.

Shqipërimi përmes adoptimit do të lehtësonte formimin e mendimit me premisë të parë: "Unë flas/shkruaj shqip dhe mendoj si evropian". Shqipërimi përfshin edhe tekstet shkollore me autorë/skuadra shqiptare.

Reforma shqiptare ka standardizuar tekstet shkollore sipas nivelit evropian, duke mundësuar deri në tri alternativa. Por sirtari shqiptar në Bibliotekën Ndërkombëtare të Teksteve Shkollore dy gjuhësh është ende bosh. Aty vendosen tekste që formojnë mendimin perëndimor, ku dija, mençuria dhe vlera ndërtojnë kompetencën e jetës. Mirëpo ende tekstet shkollore shqiptare kanë probleme. Skuadrat e teksteve vazhdojnë të pa distancuar nga sistemi i mendimit ideologjik. Për pasojë tekstet shkollore ende kanë fraza të gjata, gabime shkrimi e keq përdorime. Ato nuk shërbejnë aq sa duhet si burime të vërtetash dhe si metodologji e metoda për të lehtësuar nxënien, duke ju përgjigjur pyetjes së nxënësit "si ta kuptoj këtë"?

### **Funksioni i dyfishtë i nxënies së gjuhëve**

Ndërtimi i mendimit kritik dhe i kompetencës së komunikimit janë dy fushat prioritare të procesit mësimor përmes nxënies së gjuhës amtare dhe të gjuhëve të tjera. Sistemi i mendimit fillon me nxënien logjike e racionale kritike transendente të gjuhës amtare/gjuha familjare. Ky është ligj për të gjitha gjuhët dhe i mbron ato nga gabimet logjike. Krahasimi i gjuhës shqipe me gjuhët e tjera është mjeti më i sigurt për ndërtimin e arsytimit logjik. Fjalitë në të gjitha gjuhët përdoren, por propozimet, premisat, nuk janë në të njëjtën marrëdhënie me argumentet.

Shembulli në vijim është klasik dhe ilustron se një premisë është zakonisht ajo që pohohet, por jo fjalja vetë. Çdo pohim mund të jetë i vërtetë ose jo i vërtetë. Edhe pse e vërteta apo falsiteti i një deklaratë mund të jetë i panjohur.

It's raining (eng)

Esta lloviendo (sp)

Is plent (fr)

Es regnet (ger)

Po bie shi (shqip)

Është duke rënë shi (shqip)

Janë pesë gjuhë të ndryshme, gjashtë fjali dhe një kuptim në një premisë pohore deklarative. Konkluzioni është proces arsytimi, në të cilin besimi formohet në bazë të provave ose nga besime të tjera. Në shek. XVIII, Volteri shkroi "Nëse Zoti nuk do të ekzistonte, do të ishte e nevojshme ta shpiknim". Këtu, asnjë nga dy komponentët nuk pohohet: As, "Zoti nuk ka/ekziston", as "Zoti është e nevojshme ta shpikim". Vetëm propozimi "nëse/ahere" është pohim hipotetik/kushtëzuar, dhe mund të jetë i vërtetë edhe nëse të dy përbërësit e tij janë false.

Dhe sot secili nga ne, duke kuptuar logjikisht gjuhën, e konsideron premisën "Zoti ekziston" të vërtetë, sa e si edhe "Zoti nuk ekziston", për shkak të mungesë së provës logjike si dhe të eksperimentit.

Duke nxënë më shumë se një gjuhë jo vetëm përmirësohen aftësitë e komunikimit, por ndërtohet kompetenca e komunikimit dhe e interkomunikimit. Përvetësimi i një gjuhe tjetër kalon përmes strukturave të ndryshme gjuhësore dhe konteksteve kulturore, që rrisin fleksibilitetin njohës. Kjo aftësi për menduar, njohur dhe përshtatur me këndvështrime të ndryshme, është komponent kyç i të menduarit kritik dhe bazë e sigurt për të ndërtuar vlerat njerëzore. Fleksibiliteti kuptimor, aftësitë për zgjidhjen e problemeve dhe ndërjegjësimi kulturor janë thelbësore për të menduarit kritik. Paqartësia e "të menduarit" dhe mungesa e teorive të përshtatshme që shmangin reduktimin konjitiv ose gjuhësor janë problem i vazhdueshëm. Të menduarit, nuk mund të reduktohet në aktivitet njohës dhe nuk mund të ketë të menduar racional (mendim akademik) pa gjuhë të qartë (Kahneman, 2013).

Ka ardhur koha që fusha e transitologjisë së mendimit të gjuhës të jetë baza teorike e kuptimit të të menduarit, e ndërtimit, lëvizjes lineare transitive si dhe e proceseve gjuhësore dhe njohëse në epokën e Inteligjencës Artificiale [AI].

### **Sistemi i ri i mendimit dhe kurrikula shkollore**

Filozofia post moderne ç'vlerësoi "besimin në mendjen njerëzore" përmes veprës së E. Frojdit [Sigmund Freud] duke e ndarë mendjen në "Id, Ego dhe Superego". Tranzicioni nga të menduarit ideologjik në mendimin kritik, kërkon ndryshime radikale në kurrikul dhe tekste. Kjo do të thotë kapërcim nga filozofia materialiste e gjuhës në filozofinë kritike transhendentale. Rikonceptimi i sistemit dhe procesit të edukimit kërkon që, në themel të formimit të brezit të ri të vendoset sistemi i të vërtetave pluraliste me bazë të vërtetat e mëdha të metafushave klasike: filozofi, fe dhe shkencë. Përmes edukimit mund të ndërtojmë kompetencën e multi-komunikimit dhe brezat pasardhës do sigurojnë e garantojnë të ardhmen e jetesës paqësore.

Premisa e parë e këtij arsytimi është formimit historiko-gjeografik dhe moralo-qytetar brezit të ri në epokën e post-ideologjike mbi bazën e të vërtetave të mëdha fetare, filozofike e shkencore. Vdekja e ideologjisë na detyron që tekstet shkollore të historisë, gjeografisë, edukatës morale qytetare të jenë sipas modelit evropian: fusha me substrat jetën dhe qytetërimin përmes institucioneve dhe vlerat e orientuara të qytetërimit shqiptar që nga lashtësia deri në ditët tona: Njësia sintaksore "Jeta e shqiptarëve dhe e institucioneve" do të ishte titulli më i përshtatshëm i tekstit shkollor të sotëm të "Histori e Shqiptarëve dhe e trojeve të tyre". Formimi historik në shkollën shqiptare mund të ndërtohet me tekstin (dy gjuhë) "Shqipëria në historinë e përbashkët Evropiane" [A common European history textbook]. Ky titull i librit të historisë shkollore është nga viti 1950 dhe është pranuar nga International Textbook Institut George Eckert Brunswick Germany. Me të njëjtën metodë arsytimi mund veprojmë të edhe për tekstet shkollore "Gjeografi" "Edukatë". Ndryshe, formimi dhe edukimi në këto fusha dije do të degradojë në neo-nacionalizma e neo-identitete të shkruara shqip, por të pakuptueshme për një identitet shqiptaro-evropian që komunikon shqip dhe në gjuhë të tjera jo amtare. Është koha të përcaktohet seti i vlerave njerëzore që synon formimi dhe edukimi në gjithë godinën e sistemit të arsimit. Kjo premisë e koncepton dijen si përvetësim i të dhënave dhe informacionit, ndërsa mençuria si aplikim praktik dhe përdorimi i njohurive për të krijuar vlerë. Mençuria fitohet përmes mësimit dhe përvojës praktike, jo vetëm përmes të mësuarit përmendësh (Russell, 2022).

### **Shkrimi digjital dhe bukurshkrimi**

Transformimet digjitale të shkrimit po ndodhin me ritëm të shpejtë dhe nuk lejojnë hapësirë kohe që shoqëria të rikujtojë të kaluarën nga epoka e hekurit dhe koha e puplës, pendës me bojë, makinës së

shkrimin. Në epokën tonë, jo vetëm në shkrim-lexim, por edhe në gjitha fushat, digjitalizimi është e sotmja dhe e ardhmja. Mendja lehtësoi shkrimin e mendimit përmes revolucionit digjital ashtu si bëri edhe J. Gutenbergu në shek. XV. Në format e zhvilluara e tij, shkrimi është mënyrë e strukturimit ose transformimit të njohurive (Kellogs, 2008; Bereiter & Scardamelia, 1987). Të shkruarit dhe të menduarit janë të ndërvarura nga niveli i aftësive intelektuale dhe përbëjnë bazën të gjitha niveleve të mendimit që nga ai naiv/sinkretik (mitologjik) deri të niveli më i lartë filozofik.

Të shkruarit bukur dhe të lexuarit rrjedhshëm (pa pengesa) janë veprimtari të bazuara në vlerën e parë ontologjike njerëzore "e bukura" e shprehur si kategori estetike, si raport mes të rregulltës dhe të parregulltës, mes entropisë\* dhe informacionit. Ky "raport i artë" (prerja e artë e Aristotelit) është themeli i mendimit racional kritik perëndimor. E bukura aq sa është një kategori estetike e ndërtuar nga përjetimi estetike, është më së pari vlera ontologjike njerëzore. Ajo fillon të ndërtohet në moshën foshnjore, përmes racionalitetit (ratio) dhe ekuilibrit e njohjes empirike foshnjore. Bukurshkrimi (të shkruarit bukur) është "prova" e parë e racionalitetit të fëmijës, kur pas lodrave fillon të shkruajë e të vizatojë (pikturojë) dhe mendja e tij diferencon të largëtën nga e afërta, të voglën nga e madhja: shkronja e vogël dhe shkronja e madhe e dorës dhe e shtypit. Në këtë fazë të rritjes, fëmija komandon lëvizjet e duhura të duarve e të organeve të tjera në mënyrë e në përshtatje me botën përtej tij. Ky është një fenomen vetëm njerëzor.

Të menduarit ka nevojë për simbolet leksikore, format gramatikore dhe lidhjet gjuhësore duke ndërtuar konceptin, gjykimin e arsytimin, përmes operacioneve logjike e njohëse. Shkrimi me kompjuter është zbulim i radhës i mendjes njerëzore, që udhëheq qenien në udhëtim duke njohur e respektuar ligjet ontologjike e gnoseologjike të shoqërisë të integruara me ligjet objektive të natyrës. Kaligrafia sot përfshin dizajnin grafik, pikturën, hartat, menutë, kartolinat, ftesat, dokumente ligjore, diploma, mbishkrime, rekuizita dhe imazhe lëvizëse për filma dhe televizione, kartat e biznesit, modele pune me dorë, etj. Epoka digjitale ka lehtësuar krijimin dhe shpërndarjen e mijëra shkronjave të reja dhe të stiluara historikisht. Interneti on-line lehtëson punën e dorës së kaligrafëve dhe artistëve me germa të dorës. Kjo do të thotë se propozimi shqiptar për të hequr shkrimin e dorës është i palogjikshëm dhe pa argument.

## Sugjerime

1. Rikonceptimi i filozofisë si kalim nga mendimi ideologjik në të menduar filozofik
2. Fakultetet e edukimit që formojnë dhe përgatitin mësues në profilet e lëndëve shoqërore, sidomos për histori-gjeografi, edukim qytetar dhe shkenca shoqërore, duhet të bëjnë ndryshime në kurrikul duke e pasuruar atë me module që përfshijnë integrimin e shkencës, fesë dhe filozofisë në procesin e arsimit dhe të edukimit laik përmes shkencave të edukimit.
3. Institucionet e ngarkuara me ligj për zhvillimin profesional të mësuesit gjatë jetës të përgatisin e të fillojnë zbatimin e programit të trajnimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve që zhvillojnë njohuritë për fenë dhe besimet në sistemin shkollor parauniversitar.

## Referenca

- Anson, C. M. (2021). After the big bang: The expanding universe of writing studies. In Higher education (pp. 5–26). Peter Lang.
- Bazerman, C. (2011). The disciplined interdisciplinarity of writing studies. *Research in the Teaching of English*, 46(1), 8–21.

- Bush, R. A. (2021). *Designing the mind: The principles of psychitecture*. Amazon LLC.
- Copi, J. M., Cohen, C., & McMahon, K. (2016). *Introduction to logic* (14th ed.). Routledge.
- Cummins, J. (2001). Bilingual children's mother tongue: Why is it important for education? *Sprogforum*, 19(2), 15–20. University of Toronto.
- Duro, A. (2009). Termi dhe fjala në gjuhën shqipe. Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Jones, A. F., & Wang, L. (2011). *Spectacular creatures: The Amazon rainforest* (2nd ed.). San José: Costa Rica Publisher.
- Kahneman, D. (2013). *Thinking, fast and slow*. Farrar, Straus and Giroux.
- Mitchell, J. A., Thomson, M., & Coyne, R. P. (2017). *A guide to citation*. London, England.
- Naim, A. B. (2008). *A farewell to entropy: Statistical thermodynamics based on information*. World Scientific Publishing.
- Nathanaili, V. (2016). *Rruga e mundimshme e shkollës shqip: Çështje, politika & veprimtari në fushën e arsimit, 1912–1944*. UET Press.
- Parliamentary Assembly. (2006). The place of mother tongue in school education. Report of the Committee on Culture, Science and Education.
- Pingel, F. (2013). *History education and post-conflict reconciliation*. Routledge.
- Stroinska, M. (2002). Language and totalitarian regimes. *Economic Affairs*, 22(2), 18–23.
- Sahu, S., & Co. (2021). Evolution of philosophy from Greek to postmodern: A debate. *International Journal of All Research Education and Scientific Methods*, 7(7A). <https://doi.org/10.22271/allresearch.2021.v7.i7a.8722>
- Eco, U. (2005). *Në kërkim të gjuhës së përkryer në kulturën evropiane* [La ricerca della lingua perfetta nella cultura europea]. Tiranë: Dituria.